

PAULA HAWKINS

Vajza në tren

MORAVA



Paula Hawkins

# Vajza në tren

Përktheu: Taulant Hatia

Shtëpia Botuese MORAVA

Titulli i origjinalit:  
*The Girl on the Train*

Paula Hawkins

Redaktore: Nora Sula  
Formulimi grafik: Gerta Kambo

Copyright © Paula Hawkins 2015

© Copyright për botimin në shqip MORAVA 2015

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe i takojnë Shtëpisë Botuese MORAVA. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

*Për Kejtin*



E varrosën nën një mështeknë të argjendtë, atje poshtë, te shinat e trenit. Varrin ia shënuan me një pîrg gurësh. Në fakt, asgjë më tepër se një pîrg gurësh. Nuk dua të flas për vendin ku prehet, por as pa e përmendur nuk mund ta lë. Do të flejë aty përjetësisht, nuk do ta trazojë më asnjë njeri, asnjë zhurmë, veç këngës së zogjve dhe gjëmimit të trenave që kalojnë.





Njëshi për dhimbjen, dyshi për gëzimin, treshi për një vajzë. Treshi për një vajzë. Kam mbetur te treshi, nuk bëj dot më tutje. Koka më zien nga zhurmat, goja më është trashur nga gjaku. Treshi për një vajzë. Arrij t'i dëgjoj laraskat si qeshin, si tallen me mua me atë krrokamën e ngjirur. Një lajm. Lajme të këqija. I shoh, të zeza, ndërsa zënë diellin. Nuk janë zogjtë, por diçka tjetër. Po vjen dikush. Dikush po më flet. *Shikoje tani. Shiko se ç'më detyrove të bëj.*



# REJÇËLLI

*E premte, 5 korrik 2013*

*Mëngjes*

NJË PIRG RROBASH ishte buzë shinave të trenit. Rroba të kaltra të zbehta, ndoshta ndonjë bluzë e përzier me diçka të bardhë por të ndotur. Mund të ishin hedhurina që i kishin flakur buzë shkurreve. Mund t'i kishin lënë inxhinierët që punojnë në këtë copë hekurudhe sepse vijnë shpesh. Por mund të jenë edhe ndonjë gjë tjetër. Mamaja gjithmonë më thoshte se kam imagjinatë të tepruar, po ashtu edhe Tomi. Nuk kam ç'të bëj, më zë syri gjëra të tilla të hedhura, ndonjë bluzë të pistë apo ndonjë këpucë të braktisur dhe nis të mendoj për vendin ku ndodhet këpuca tjetër apo për këmbët që futeshin dikur në to.

Kur nisi lëvizjen, treni u shkund, kërciti e fërshëlleu, pirgu i rrobave m'u zhduk nga sytë dhe lëvizëm drejt Londrës me përtaci. Dikush në ndenjësen pas meje shfryu i acaruar. Treni i ngadaltë i orës 8.04 nga Eshbëri në Juston i vinte në provë durimin edhe udhëtarit më të sprovuar. Udhëtimi duhej të zgjaste pesëdhjetë e katër minuta, por kjo ndodhte rrallë: kjo pjesë e trasesë ishte e vjetruar, e mbushur me probleme sinjalizimi dhe me punime të pafundme inxhinierike.

Treni u zvarrit përpara, kaloi pranë dyqaneve e kullave të ujit, nëpër ura e hangarë, anës shtëpive modeste viktoriane që u kishin kthyer shpinën shinave.

Me kokën mbështetur pas dritares, i shihja këto shtëpi që më kalonin si nëpër film. I shihja siç nuk dinin t'i shihnin të

tjerët, as të zotët e tyre ndoshta nuk dinin t'i shihnin si unë. Dy herë në ditë më ofrohej kjo pamje e jetëve të tyre vetëm për pak çaste. Ka diçka që të ngushëllon kur sheh të panjohurit që rrinë të sigurt në shtëpitë e tyre.

Dikujt i ra telefoni. Si zile kishte një këngë ritmike dhe të gëzueshme. Mezi u përgjigjën se melodia zgjati goxha. Ndieja bashkudhëtarët që lëviznin në vendet e tyre, shfletonin gazeta, shtypnin në kompjuter. Treni mori me përtesë kthesën dhe ngadalësoi kur iu afrua një sinjali të kuq. I hoqa sytë nga dritarja dhe u mundova të lexoja gazetën falas që mora në stacion, por fjalët i shihja në mjegull dhe asgjë nuk më ngjallte interes. Në mendje më kishte mbetur ai pingu i rrobave i braktisur buzë shinave.

### *Mbrëmje*

Lëngu i përzier me xhin dhe tonik më lëshoi bulëza te buzët, kur e hapa kanoçen dhe e afrova në gojë. Aromatik dhe i ftohtë, si shija e pushimeve të para me Tomin në një fshat peshkatarësh në brigjet baske në vitin 2005.

Mëngjeseve notonim ato pak qindra metra deri në një ishull të vogël përballë gjirit dhe bënim dashuri nëpër plazhet e fshehta; pasditeve uleshim në bar e pinim një xhin të fortë me tonik duke parë tufat e djemve që luanin rrëmujshtëm futboll në rërën që linte pas zbatice.

Piva edhe një gllënjë, pastaj edhe një tjetër. Kanoçja shkoi përgjysmë, por pak rëndësi kish, kisha edhe tri të tjera në qesen plastike që mbaja te këmbët. Ishte e premtë, kështu që nuk kisha pse ndihesha fajtorë se po pija në tren. TGIF\*. Aty niste qejfi.

Pritej fundjavë e këndshme, kështu kishin thënë. Me diell, me një qiell pa re. Të ishte kohë tjetër, mund të shkonim në Korli Ud për piknik, ta kalonim gjithë pasditen shtrirë mbi çarçafë, nën rrezet e diellit, duke pirë verë, mund të piqnim

---

\* Akronim i *Thank God It's Friday* (Lavdi Zotit është e premtë). [Shën. Përkhth.]

ndonjë gjë me shokët apo të shkonim në kopshtin e birrës Trëndafili, me fytyrat që na skuqnin nga dielli e nga alkooli, pastaj të ktheheshim në shtëpi të kapur për krahu e të na zinte gjumi në divan.

Tani kisha një diell të bukur e një qiell pa re, por nuk kisha me kë të luaja, nuk kisha çfarë të bëja. Kjo jetë, siç po jetoja tani, bëhet më e vështirë gjatë verës kur ka më tepër ditë e më pak natë, kur të gjithë dalin jashtë dhe kënaqen pa fre. Është e lodhshme, të bën të ndihesh keq nëse nuk përzihesh me ta.

Ndieja gjithë fundjavën të shtrihej përpara meje, plot dyzet e tetë orë të zbrazëta që duheshin mbushur. E ngrita edhe një herë kanoçen dhe i dhashë fund.

*E hënë, 8 korrik 2013*

*Mëngjes*

U lehtësova që u ktheva në orën 8.04. Jo se mezi prisja të kthehesha në Londër e të nisja javën e punës, se, në fakt, nuk dua të rri fare në Londër. Më shumë më pëlqente të rrija ulur në ndenjësen e butë prej lëkure, të ndieja ngrohtësinë e diellit nga dritarja, lëkundjet sa para-mbrapa të vagonit dhe ritmin e njëtrajtshëm të rrotave të trenit. Më shumë më pëlqente këtu, të rrija e të shihja shtëpitë anash hekurudhës, sesa kudo gjetkë.

Në këtë linjë kishte një sinjal gabim, diku nga mesi i rrugës. Mendova që duhej të ishte gabim, sepse e shihja gjithnjë të kuq. Ndalnim gati përditë aty, ndonjëherë vetëm pak sekonda, ndonjëherë shumë minuta. Kur ulem në vagonin D, gjë që e bëj zakonisht, dhe kur treni ndalon te ky sinjal, gjë që e bën pothuajse përherë, kam një pamje të përsosur të shtëpisë sime të parapëlqyer, asaj me numër pesëmbëdhjetë.

Numri pesëmbëdhjetë ngjan me shtëpitë e tjera në këtë pjesë të hekurudhës: stil viktorian, dykatëshe, me pamje nga një kopsht i vogël por i mbajtur mirë, gati shtatë metra i gjatë deri te gardhi pas së cilit ndodhet një tokë e zbrazët disa metra

e gjerë përpara binarëve. E kam mësuar përmendsh këtë shtëpi, i njoh çdo tullë, ia mbaj mend edhe ngjyrën e perdeve në katin sipër (bezhë me ca lule të errëta blu), di edhe që boja është rrjepur nga korniza e dritares së banjës dhe nga ana e djathtë e çatisë mungojnë katër tjegulla.

Di që mbrëmjeve të ngrohta të verës të zotët e shtëpisë, Xhejzoni dhe Xhesi, ndonjëherë ngjiten e ulen në tarracën e vogël, që del nga shtesa e kuzhinës. Duken si çift i përsosur. Ai ka flokë të zinj, trup të gjatë e të fortë. Qesh me zë të lartë. Kurse ajo është nga ato gratë trupvogla e bukuroshe, me lëkurë të bardhë e flokë të verdhë të prerë shkurt. Ka mollëza të mprehta e të mbushura me quka dhe mjekër mjaft të këndshme.

Kur presim aty te sinjali i kuq, rri e i shikoj. Xhesi del më shpesh mëngjeseve, sidomos në verë, dhe e pi aty kafën. Ndonjëherë më bëhet sikur edhe ajo më sheh e më vjen ta përshëndes me dorë. Xhejzonin nuk e shoh aq shpesh, me sa duket është në punë. Por edhe kur nuk janë aty, rri e mendoj se ç'duhet të jenë duke bërë. Ndoshta sot e kanë të dy pushim dhe ajo nuk është ngritur ende nga shtrati, kurse ai përgatit mëngjesin, ndoshta kanë dalë të dy të bëjnë vrap, sepse këto gjëra bëjnë (edhe unë me Tomin dilnim me vrap të dielave. Unë vrapoja pak më shpejt se ritmi normal, kurse ai me gjysmën e ritmit të tij vetëm që të vraponim krah për krah). Ndoshta Xhesi ndodhet në dhomën e katit sipër e po pikturon, mund edhe të jenë futur të dy në dush dhe po bëjnë dashuri.

### *Mbrëmje*

Me shpinën nga pjesa tjetër e vagonit, u ktheva lehtë nga dritarja dhe hapa një nga shishet e vogla me verën e bardhë Shenin, që i kisha blerë në Justin. Nuk ishte e ftohtë, por prapë pihej. Hodha pak në një gotë plastike, i vura tapën dhe e futa shishen në çantën e dorës. Nuk qe gjë e zakonshme të pije në tren të hënave, veç rasteve kur ishte me shoqërinë. Po ja që unë isha vetëm.

Në këta trena, kishte fytyra të njohura, njerëz që i shihja çdo javë, që shkonin e vinin. Siç i njihja unë, mund të më njihnin edhe ata. Megjithëse nuk ma merr mendja se më shihnin për atë që jam në të vërtetë.

Mbrëmja ishte e këndshme, e ngrohtë, por jo e nxehtë; dielli kishte filluar të perëndonte plot përtesë, hijet kishin nisur të zgjateshin dhe rrezet e fundit i kishin veshur pemët me ngjyrë ari. Treni kaloi përpara shtëpisë së Xhejzonit dhe Xhesit, kur dielli po perëndonte. Ndonjëherë, por jo shpesh, mund t'i shihja edhe nga kjo anë e hekurudhës. Kur nuk vinte tren nga kahu tjetër dhe kur ecnim ngadalë, arrija t'i dalloja në tarracë. Nëse jo, i përfytyroja; Xhesi që ulur me këmbët mbi tryezën e tarracës e me gotën e verës në dorë, kurse Xhejzoni i rrinte pas me duart mbi supe. Përfytyroja edhe ndjesinë e atyre duarve, peshën e tyre, sigurinë dhe mbrojtjen që ofronin. Ndonjëherë e kapja veten duke u munduar të kujtoja herën e fundit kur kam pasur një kontakt fizik të qëllimshëm me një tjetër njeri, një përqaftim apo një përkëdhelje dashamirëse dore, dhe ndieja zemrën të më ndrydhej.

*E martë, 9 korrik 2013*

*Mëngjes*

Pirgu i rrobave i javës së shkuar ndodhej ende aty. Dukej më i pluhurosur e i pistë se para pak ditësh. Diku kisha lexuar se treni mund të t'i heqë rrobat nga trupi kur të përplas. Vdekjet nga treni nuk janë aq të pazakonta. Dy apo treqind në vit thonë, çka është të paktën një në çdo dy ditë. Nuk jam e sigurt sa prej tyre janë aksidentale. Kur treni u kaloi pranë, vështrova me kujdes mos shihja njolla gjaku te rrobat, por nuk dallova gjë.

Treni ndaloi te sinjali, si zakonisht. Dallova Xhesin, që po rrinte në verandën e jashtme. Kishte veshur një fustan me ngjyrë të çelët dhe që këmbëzbathur. Kokën e kishte kthyer e

shihte në drejtim të shtëpisë, ndoshta po fliste me Xhejzonin i cili mbase po bënte mëngjesin. Ia ngula sytë Xhesit e shtëpisë së saj, kur treni nisi lëvizjen. Nuk doja të shihja shtëpi të tjera, sidomos të katërtën pas saj, atë që dikur ishte e imja.

Kam jetuar në shtëpinë numër njëzet e tre në rrugën Blenhajm për pesë vite të lumtura e të bekuara. Tani nuk e shoh dot me sy. Ajo ishte shtëpia ime e parë. Jo shtëpia e prindërve, jo ndonjë shtëpi ku rrija me studentë të tjerë, por shtëpia *ime* e parë. Tani nuk më vjen ta shoh. Në fakt, mund ta shoh, e bëj ndonjëherë, edhe dua edhe nuk dua, më shumë përpiqem të mos e shoh. Çdo ditë i them vetes të mos e shoh, por prapë e shoh çdo ditë. Nuk duroj dot, megjithëse nuk ka asgjë për t'u parë, megjithëse gjithë çka shoh më trishton. E shoh, megjithëse e mbaj mend shumë mirë si u ndjeva kur vura re për herë të parë se ngjyra e kemit e dhomës së gjumit në katin sipër që zëvendësuar me rozë, megjithëse e mbaj mend shumë mirë dhimbjen që ndjeva kur pashë Anën që vadiste trëndafilat anës gardhit, e veshur me një bluzë të ngushtë mbi barkun e fryrë, dhe kafshova buzën aq sa e gjakosa.

Mbylla sytë dhe numërova deri në dhjetë, pesëmbëdhjetë, njëzet. Tani iku, nuk kisha ç'të shihja më. Hymë në stacionin Uitni dhe dolëm prej tij, treni hyri në rrethinat që nisën të përziheshin me veriun e Londrës ku dukeshin plot ura e ndërtesa të zbrazëta me dritare të thyera. Sa më shumë i afroheshim Justonit, aq më në ankth ndihesha. Më shtohet trysnia se si do të shkonte ajo ditë. Gati pesëqind metra para se të hynin në Juston, në anën e djathtë të shinave, ndodhej një ndërtesë e pistë prej betoni. Në njëren faqe të saj, dikush kishte shkruar me bojë: JETA NUK ËSHTË NJË PARAGRAF. M'u kujtua përsëri pirgu i rrobave buzë hekurudhës e m'u bë një lëmsh në grykë. Jeta nuk është paragraf dhe vdekja nuk është parantezë.

### *Mbrëmje*

Treni që mora në mbrëmje, më 17.56, ishte më i ngadaltë se ai i mëngjesit. Iu desh një orë e një minutë që të arrinte,